



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 2 AKTI

NR. 24 VENDIMI

Tiranë, më 13.06.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Roland Ilia	Anëtar
Xhensila Pine	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 08.06.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë nga avokat prof. dr. Maksim Haxhia.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE : Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, **Ë** të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”);

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “Ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Xhensila Pine, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin zhvilluar më datë 06.11.2017, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”).

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 06.11.2017.

Në mbledhjen e parë të trupit gjykues nr. 3 u caktua kryesuese e trupit znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Bashkim Dedja.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

LDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, duke krahasuar: “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”; Deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me institucionet publike.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të ILDKPKI-së, kjo e fundit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- a. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 15.05.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 15.05.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 18.05.2018, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 28.05.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjyqësor, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 08.06.2018, ora 10:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, ai u mbrojt me anë të avokatit, prof. dr. Maksim Haxhia, i cili dha shpjegimet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, avokati i subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Bashkim Dedja ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017^[1]

[1] “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “*procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë*”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit

dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 08.06.2018, gjatë seancës dëgjimore;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit.

Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

1. Tokë arë, 2000 m², ndodhur në fshatin ***, Dibër, marrë në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, në emër të babait O., i ndarë nga jeta në vitin 1993. Deklaroni se keni 50% të pronësisë.

Rezulton se:

Nga ana juaj nuk është bërë çelja e trashëgimisë për babain tuaj, z. O. D., nëpërmjet së cilës caktohet cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese të secilit trashëgimtar.

Për sa më sipër, nuk provoni me dokumentacion justifikues pronësinë mbi këtë tokë, si dhe pjesën takuese 50%.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se origjina e kësaj pronësie ka qenë ligji nr. 7501 “Për tokën”, në bazë të të cilit ka përfituar pjesën takuese për frymë të tokës bujqësore si banor në Njësinë Administrative ***, Qarku Dibër. Në vitin 1991, subjekti ka qenë banor i Njësisë Administrative ***, Prefektura Dibër, për pasojë ishte përfitues i drejtpërdrejtë i ndarjes së tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991. Ky fakt provohet me certifikatën e trungut familjar dhe me aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. 19116, datë 01.07.1994. Ky akt i marrjes së tokës në pronësi është lëshuar në të gjitha rastet në emër të kryefamiljarit të familjes, që në atë kohë ka qenë babi i

kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

tij, i ndjeri O. I. D., (sipas rregullimit në Kodin Civil të bashkëpronësisë së familjes bujqësore).

Regjimi juridik i kësaj pasurie, që i përket familjes bujqësore, rregullohet nga neni 222 e vijues i Kodit Civil. Pra, gjendja aktuale e saj, është siç ka qenë në kohën e përfitimit të saj, e pandarë, pasi asnjë nga anëtarët nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Regjistrimi përfundimtar i kësaj pasurie në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Dibër nuk është bërë ende.

Subjekti i rivlerësimit është larguar fizikisht nga familja e tij në Dibër në vitin 1988, duke qëndruar në Mat e pastaj në Tiranë. Kur është ndarë toka bujqësore në fshatin e tij dhe është tërhequr akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), subjekti i rivlerësimit ka pyetur vëllain e tij, L., dhe verbalisht ai ka thënë që i është dhënë dy dynym tokë, kështu që ai dhe vëllai tjetër, M., kishin nga një dynym tokë, sipas ligjit të sipërcituar. Këto dokumente ai nuk i ka parë vetë, duke i besuar asaj që i kishte thënë i vëllai. Ndërsa L. me familjen e tij kanë përfituar rreth gjashtë dynym tokë.

Ky fakt është i pasqyruar edhe në deklarin e pasurisë në vitin 2003, kur është bërë për herë të parë deklarata periodike nga ana e subjektit. Faktikisht, nga AMTP-ja ka rezultuar që kjo sipërfaqe nuk është 2000 m², por 1652 m². Ky është një lapsus nga ana e subjektit të rivlerësimit, që ka ardhur për shkak të mosverifikimit të dokumentit përkatës, por duke i marrë këto të dhëna nga vëllai i tij, L., gojarisht. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ai nuk e ka çelur dëshminë e trashëgimisë, prandaj nuk është bërë kalimi i kësaj pronësie nga babai te subjekti i rivlerësimit dhe trashëgimtarët e tjerë, edhe nëna i është ndarë nga jeta në vitin 2017. Nuk është çelur dëshmia e trashëgimisë, pasi nuk është nevojitur pjesëtimi i saj. Sipas rregullimit që bëhet nga dispozitat e Kodit Civil për pasurinë e familjes bujqësore, kjo pasuri ndahet vetëm kur e kërkon njëri nga pjesëtarët e saj. Vëllai i madh, L., kishte përfituar vetë tokë bujqësore nga ligji nr. 7501, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij, M., janë përfitues të pasurisë prej 1652 m². Motrat e tyre janë të martuara dhe verbalisht kanë deklaruar se heqin dorë nga kjo pasuri, duke ua falur vëllezërve, Bashkim dhe M., pjesët e tyre takuese të prindërve. Njëkohësisht, ato kanë shprehur gatishmërinë e tyre që ta deklarojnë këtë vullnet përpara çdo organi që u kërkohet.

Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues vlerëson se pasuria tokë arë e deklaruar për herë të parë në vitin 2003 nga subjekti i rivlerësimit është në pronësi të të ndjerit, babait të subjektit të rivlerësimit. Në bazë të nenit 318 të Kodit Civil, “trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi”. Kjo do të thotë se personat që e trashëgojnë thirren për të trashëguar dhe atyre u kalon, sipas nenit 331 të Kodit Civil, posedimi mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë dhe pa qenë e nevojshme lëshimi i dëshmisë trashëgimore. Kjo për faktin se dëshmia trashëgimore nuk kërkohet shprehimisht nga neni 318 (*trashëgimia çel kur vdes trashëgimlënësi*) dhe nga neni 333 (*me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit*) i Kodit Civil. Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë është një akt që nuk ka lidhje dhe nuk mund të përputhet me faktin e çeljes së trashëgimisë, që është një fakt natyror që lidhet me vdekjen e trashëgimlënësit. Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2003, ka deklaruar posedimin dhe pritshmërinë e tij për t’u bërë pronar. Pritshmëria për t’u bërë pronar është një koncept që ka evoluuar dhe është njohur nga Gjykata

Europiane e të Drejtave të Njeriut. Në këtë kontekst, duke qenë se posedimi është situatë fakti dhe prona është pjesë e familjes bujqësore, origjina e secilës është ligji për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pra, burimi i posedimit është pronësia e kaluar sipas ligjit të atit të subjektit të rivlerësimit me aktin e AMTP-së. Trupi gjykues vlerëson se posedimi dhe pritshmëria për t'u bërë pronar janë çështje fakti dhe derisa të regjistrohen në regjistrat përkatës, mjafton përmendja e faktit dhe origjinës ku bazohet posedimi për të konkluduar për ligjshmërinë e posedimit që rrjedh dhe prezumohet nga ligji themelor i marrëdhënieve juridike, që është neni 41, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Civil. Sipas nenit 359 të Kodit Civil, është parashikuar se pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore. Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. Edhe kjo dispozitë nuk e kërkon si kusht lëshimin e dëshmisë trashëgimore.

Në përfundim të kësaj analize, vërehet se:

- Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.
- Subjekti ka provuar faktin e posedimit mbi këtë pasuri trashëgimore.

2. Apartament banimi, me sipërfaqe 98 m², me vlerë 19.600 USD ose 1.812.020 lekë, në Njësinë Administrative Nr. ***, Rr. "***", pallati ***, sh. ***, Tiranë, fituar me kontratë sipërmarrjeje, datë 09.01.1997, kontratë individuale lidhur më datë 05.02.1997, kontratë shitjeje datë 21.08.2007, me nr. *** rep., nr. *** kol.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”:
Kursimet dhe të ardhurat.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

Bazuar në të dhënat e mbledhura rezulton se në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, subjekti nuk ka dhënë deklarime të sakta për sa i përket burimit të ardhurave për këtë pasuri, pjesëve takuese dhe vlerës reale të saj.

Referuar kontratës së sipërmarrjes, datë 09.01.1997, lidhur midis Gjykatës së Apelit Tiranë dhe firmës "***" sh.p.k. është përcaktuar një vlerë 19.600 USD për apartamentin, vlerë e cila, bazuar në aneksin e kontratës, do të shlyhej me këste si më poshtë:

1. 30% paradhënie në vlerën 588.000 lekë, në momentin e lidhjes së kontratës.
2. 30%, nëse arrijnë punimet në katin IV;
3. 30 me fillimin e punimeve të rifiniturës;
4. 10%, vlera e mbetur kur të dorëzohet objekti i përfunduar.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton të jetë dorëzuar asnjë dokument provues për kryerjen e pagesave të mësipërme.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se kontrata e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., është lidhur më datë 21.08.2007.

Nga analiza ekonomike rezultoi se nuk ka pasur aftësi paguese për të paguar këstin e parë të apartamentit në vitin 1997, prej 588.000 lekësh, për firmën “***” sh.p.k., i cili nuk justifikohet me të ardhurat e vërtetuara, për periudhën deri më 31.12.1996.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës subjektit.

Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

Në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 98 m², me vlerë 19.600 USD ose 1.812.020 lekë, në Njësinë Administrative Nr. *** , Rr. “***”, pallati *** , sh. *** , Tiranë, fituar me kontratë sipërmarrjeje, datë 09.01.1997, kontratë individuale lidhur më datë 05.02.1997, kontratë shitjeje, datë 21.08.2007, me nr. 3943 rep., nr. 1020 kol.

1. Për këtë pasuri ka mospërputhje midis “Deklaratës së Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” dhe deklaratës fillestare të interesave private të vitit 2003, për sa i përket burimit, pasi në deklaratën e vitit 2003 deklarohet se është krijuar nga të ardhura nga paga e subjektit dhe nga të ardhurat e vëllait, M. D., në emigracion, nga viti 1993 dhe pjesëve takuese, të cilat në deklaratën e vitit 2003 deklarohen se janë 50%.
2. Nga ana juaj nuk është depozituar asnjë dokument justifikues për të vërtetuar kryerjen e pagesave të kësteve të firma “***” sh.p.k., apo Gjykata e Apelit Tiranë, e cila është në cilësinë e shitësit.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, sipas të dhënave të librezës së punës dhe vendimit të KLD-së, nr. 20, datë 20.10.1993, rezulton se ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në atë periudhë, ai ka pasur këto të ardhura, gjithsej 650.000 lekë.

Duke përfshirë dhe kontributin që ka dhënë dhe vëllai i tij, i cili ka punuar në emigracion që nga viti 1993, dhe në atë kohë ishte pjesë e trungut familjar, justifikojnë plotësisht burimin e të ardhurave të blerjes së këtij apartamenti. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ai është angazhuar me mësimdhënie në fakultete të ndryshme, komisione, borde të ndryshme etj., duke krijuar të ardhura të tjera që e justifikojnë shumën e paguar për fitimin e kësaj pasurie.

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me pasurinë e mësipërme dhe me dorëzimin e dokumenteve provuese për justifikimin e pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka filluar punën si gjyqtar nga data 20 tetor 1993 deri në gusht të vitit 1996 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga gushti i vitit 1996 deri në shkurt të vitit 1998, ai ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, më pas ai ka punuar në Gjykatën e Apelit Durrës. Në këtë të fundit ka punuar deri në maj të vitit 2010. Në maj të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit është emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe pastaj edhe kryetar i saj.

Shuma e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit është 510.223 lekë. Megjithatë, ajo duhet të përfshijë në bazë të librezës së punës dhe përmbajtjes së vendimit të KLD-së nr. 20, datë 20.10.1993, sipas një përlllogaritjeje pagën bazë të gjyqtarit në atë periudhë, me këto të ardhura: tetor - dhjetor 1993, 3 muaj (pagë mesatare mujore) 6.000 lekë = 18.000 lekë; maj - dhjetor 1994, 8 muaj, (pagë mesatare mujore) 13.000 lekë = 104.000 lekë. Po sipas librezës së punës, për periudhën gusht - tetor 1993, nga punësimi në Ministrinë e Punës, 3 muaj/ (pagë mesatare mujore) 6.000 lekë = 18.000 lekë. Duke filluar nga viti 1993 deri në vitin 1997, shuma totale e të ardhurave personale të subjektit rezulton të ketë qenë në vlerën 650.000 lekë. Kjo shumë vërehet se është më e madhe se kësti i pagesës prej 588.000 lekësh, që ishte përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes për vitin 1997. Objekti i hetimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kontrolli i pasurive të deklaruara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaratave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës, së parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës për subjektet e rivlerësimit. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ka shpjeguar faktin se pasurinë e mësipërme do ta merrte së bashku me vëllain e tij, z. M. D., sepse ishin ende në një trung familjar me të dhe ishin të pamartuar. Prandaj qëllimi fillestar ishte pagimi i pasurisë së mësipërme me kontributin e të dyve, pavarësisht faktit që kontrata e sipërmarrjes ishte bërë vetëm në emrin e subjektit të rivlerësimit në vitin 1997, vit në të cilin është bërë edhe pagimi i këstit të parë të çmimit për ndërtimin e apartamentit objekt porosie. Por, më tej, vëllai i subjektit të rivlerësimit është stabilizuar dhe, pasi u pajis me leje qëndrimi të rregullt në shtetin grek, nuk tregoi më interes për të kontribuar dhe për të qenë pjesëtar i pasurisë së sipërpërmendur. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit çmohen të arsyeshme dhe do të pranohen dhe për rrjedhojë do të konsiderojë edhe kontributin e vëllait të tij për pagimin e çmimit që rrjedh si rezultat i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë e sipërpërmendur. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës për të dhënë shpjegime, është parashtruar se përveç të ardhurave të tjera të tij të deklaruara, por të papërfshira në analizën financiare dhe aftësinë paguese të tij, fillimisht ka kontribuar edhe vëllai i tij, M., i cili ka punuar dhe ka realizuar të ardhura në shtetin grek, duke filluar nga viti 1993 e në vijim dhe pajisur me leje të rregullt qëndrimi në vitin 1998 e në vijim. Pas stabilizimit, vëllai i subjektit të rivlerësimit ka krijuar familjen e tij në shtetin grek dhe, për pasojë, ai nuk kishte më interes për të vazhduar të ishte pjesë e kësaj pasurie. Krijimi i familjes dhe stabilizimi në shtetin grek konsiderohet nga ana e trupit gjykues si një shpjegim i arsyeshëm në lidhje me kalimin e kontratës së sipërmarrjes në favor vetëm të subjektit të rivlerësimit.

Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar kontributin e vëllait të tij dhe se vëllai ka punuar në emigracion, trupi gjykues do të vlerësojë çështjen nëse vëllai i subjektit të rivlerësimit kishte mundësi financiare për të kontribuar.

Sa i përket aftësisë paguese të vëllait të subjektit, i cili ka pretenduar se ka realizuar të ardhura në Greqi, pasi ka qenë rezident në atë vend, trupi gjykues vlerëson se, sa i përket tatimit dhe deklarimit të të ardhurave në vitin 1997, ishte i zbatueshëm ligji nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin për të ardhurat personale”. Sipas këtij ligji, deklarimi i të ardhurave bëhej nga personat rezidentë për të ardhura mbi 4.000 lekë në muaj, të realizuara nga burime në Shqipëri dhe jashtë saj. Persona rezidentë konsiderohen personat që qëndrojnë në Shqipëri për të paktën 183 ditë gjatë vitit tatimor. Detyrimi për mbajtjen dhe pagimin e tatimit mbi ardhurat i përkiste punëdhënësit dhe jo punëmarrësit. Ky ligj ka qenë në fuqi deri në shfuqizimin e tij nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Prandaj, dhënia e parave nga një person te tjetri në legjislacionin shqiptar tatimor nuk gjen asnjë përcaktim si realizim të ardhurash të tatueshme nga individi nga burimet që krijohen të ardhurat. Meqenëse të ardhurat nga paga e vëllait të subjektit janë realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e kuptueshme që vëllai i subjektit nuk kishte ndonjë detyrim për të deklaruar të ardhurat e realizuara në shtetin grek, dhe rrjedhimisht nuk shihet ndonjë shkak që këto të ardhura të realizuara nga vëllai i subjektit deri në vitin 1997 të konsiderohen si të ardhura të paligjshme. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se kësti i parë, pjesë e pagimit të çmimit të kontratës së sipërmarrjes prej 588.000 lekësh, në momentin e lidhjes së kontratës bashkërisht me vëllain e tij, janë në përputhje me gjetjet e hetimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në lidhje me ndryshimin e pjesës takuese në favor të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se kontrata e sipërmarrjes, e vitit 2007, nuk atribuon kalimin e pronësisë së punës së kryer. Në rastin konkret, kur është bërë kontrata e shitjes në vitin 2007, vëllai i subjektit të rivlerësimit kishte krijuar familjen dhe jetën e tij dhe, në këto rrethana, ai nuk ishte më pjesë e kontratës për shkak se ishte stabilizuar në Greqi. Këtë fakt, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2007, kur është bërë kontrata e blerjes së apartamentit dhe në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë më pjesë e apartamentit. Në këto kushte, mospërfshirja e një burimi që ka ekzistuar më parë, por që nuk ekziston më në momentin e deklarimit në formularin e vetting-ut, i cili ka për objekt vetëm deklarimin e pasurive ekzistuese, çmohet se nuk përbën shkak për fshehje të pasurisë apo deklarim të pasaktë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe sipas nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket justifikimit të pagesave për pagimin e kësteve te shoqëria sipërmarrëse “***” sh.p.k., trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia juridike e sipërmarrjes, e rregulluar sipas nenit 850 e vijues të Kodit Civil, është një marrëdhënie detyrimi, e cila në thelb nuk bën kalimin e pronësisë së veprës, apo ndërtimit a shërbimit të kryer. Në bazë të nenit 851 të Kodit Civil, por edhe të praktikës së ndjekur, çmimi i punës së sipërmarrjes, ose tregohet në kontratë dhe paguhet me këste, ose kur palët nuk e kanë caktuar çmimin e sipërmarrjes dhe as nuk kanë vendosur mënyrën për ta

përcaktuar atë, ai llogaritet në bazë të tarifave ekzistuese ose në bazë të zakonit të vendit. Në rast mosmarrëveshjeje, çmimi caktohet nga gjykata. Çmimi i plotë paguhet në përfundim të punimit të sipërmarrjes me dorëzimin e sendit dhe hartimin e kontratës përfundimtare të blerjes së sendit, në rastin konkret të apartamentit të banimit. Për shkak të të papriturave gjatë ekzekutimit të kontratës, dhe rrezikut që ndërmerret, është e parashikuar në skemën e kontratës së sipërmarrjes eventualiteti i ndryshimit të projektit të sipërmarrjes dhe rrjedhimisht edhe i çmimit të rënë dakord. Sipas nenit 859 të Kodit Civil, në qoftë se për kryerjen e veprës sipas standardeve është e nevojshme që projekti të ndryshohet dhe për këtë gjë palët nuk merren vesh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata. Në qoftë se ndryshimet në çmime tejkalojnë një të gjashtën e madhësisë së çmimit të caktuar, sipërmarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe, sipas rrethanave, një shpërblim të përshtatshëm të dëmeve. Në qoftë se ndryshimet janë të konsiderueshme, porositësi mund të tërhiqet nga kontrata duke paguar një dëmshpërblim të përshtatshëm. Kështu, jo çdo ndryshim i kushteve dhe i çmimit duhet të konsiderohet si indice e dyshimtë, sidomos për pagesa të kryera gjatë një periudhe kohore kaq të gjerë, që përfshin janar 1997 deri më 2007. Në rastin konkret, shoqëria “***” sh.p.k. ka konfirmuar me shkresën, datë 16.04.2018, se janë kryer pagesat për këtë apartament nga ana e subjektit të rivlerësimit. Duke qenë një detyrim kontraktor si të gjitha detyrimet e tjera, në bazë të nenit 473 të Kodit Civil, ky konfirmim i kreditorit me shkrim, dhënë në mënyrë vullnetare, me anë të të cilit pranohet ekzekutimi i detyrimit, shkarkon palën debitore nga detyrimi për të provuar pagesat e mëparshme të parashikuara në kuadër të ekzekutimit të detyrimeve, që kanë ardhur si rezultat i kontratës së sipërmarrjes.

Gjithashtu, trupi gjykues mori në konsideratë edhe faktin e kalimit të një periudhe kohe të konsiderueshme nga data e hartimit të kontratës së shitblerjes, datë 21.08.2007, ku konfirmohet shlyerja e kësteve dhe se kontrata e shitblerjes e konfirmon pagesën e kësteve. Në të tilla rrethana, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e paraqitura arrijnë të provojnë aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri.

Në përfundim të kësaj analize, konstatohet se:

- Ka pasaktësi në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” dhe deklarimet ndër vite lidhur me pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti, por subjekti i ka sqaruar këto pasaktësi. Referuar kohës kur kjo pasuri është blerë, vitit 1997, çdokush mund të gjendet në situata të pamundësisë për të qenë i saktë në deklarime, por sqarimet e dhëna treguan se subjekti ka pasur mundësi financiare për të blerë këtë pasuri të paluajtshme dhe se pasaktësitë nuk kanë qenë të qëllimshme.
- Shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pronë përputhen me të dhënat e administruara.

3. Apartament banimi, me sipërfaqe 146.14 m², dhe garazh me sipërfaqe 15.25 m², me vlerë 180.000 euro, të ndodhur në Tiranë, Njësia Administrative Nr. ***, Rr. “***”, P. “***”, Shk. ***, Ap. *** me nr. zone kadastrale ***, me nr. pasurie *** dhe nr. ***. Prona është regjistruar bazuar në kontratën e shitjes me rezervë të pasurisë nr. *** dhe nr. ***, datë 01.11.2013, nga shoqëria

“***” sh.p.k., dhe është bllokuar në hipotekë si garanci për shlyerjen e kredisë ndaj “BKT”-së deri në vitin 2033.

Burimi i deklaruar në “Deklaratës së Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting:

- Kredi bankare në vlerën 120.000 euro ose 16.800.000 lekë nga “BKT” me afat shlyerje 20 vjet.
- Të ardhura personale dhe të bashkëshortes në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro.
- Hua në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, marrë kumatit, z. E. C., me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2014.
- Hua në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro marrë vëllait, z. M. D., me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2014.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës subjektit.

Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

❖ Në lidhje me huan, në vlerën 10.000 euro, marrë kumatit, z. E. C., me deklaratë noteriale, nr. *** rep., nr. ***kol., datë 26.03.2014.

1. Në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. ***kol., datë 26.03.2014, nga ana juaj deklarohet se më datë 10.10.2013 i keni marrë z. E. C. shumën 10.000 euro hua. Bazuar në shkresën nr. ***prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se z. E. C. është larguar nga Shqipëria më datë 18.08.2013 dhe është kthyer më datë 17.10.2013. Pra më datë 10.10.2013, z. E. C., nuk ka qenë në Shqipëri.

2. Nuk provoni me dokumentacion justifikues aftësinë paguese të z. E. C., për dhënien e kësaj huaje.

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me dokumentacionin mbi këtë hua të marrë prej kumatit të tij, z. E. C., trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kunati i tij ka realizuar të ardhura në Itali, duke filluar nga viti 2002, dhe për një pjesë të të ardhurave ai është paguar me lekë në dorë.

Trupi gjykues vlerëson se, për sa i përket tatimit dhe deklarimit të të ardhurave në vitin 2013, është i zbatueshëm ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Sipas këtij ligji, një individ konsiderohet si rezident për qëllimet tatimore nëse qëndron në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, për më tepër se 183 ditë të një periudhe tatimore, për të ardhura të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që

realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 (dy milionë) lekë. Meqenëse të ardhurat nga paga e kunatit të subjektit janë realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e kuptueshme që për realizimin e këtyre të ardhurave do të zbatohet ligji i shtetit ku janë realizuar dhe jo ligji shqiptar.

Në lidhje me datën e dhënies së huas nga kunati subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se qëllimi dhe objekti kryesor i kontratës së huas është dhënia e një shume të caktuar parash për një periudhë të caktuar kohore. Deklarata noteriale e datës 26.03.2014 nuk përbën kontratën e huas, por deklarimin e një detyrimi të marrë në mënyrë verbale, dhe ka për qëllim të njohë borxhin e marrë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe jo domosdomërisht datën dhe mënyrën e pagesës, që janë elemente të ekzekutimit të detyrimit, jo të krijimit të detyrimit. Qëllimi kryesor i kryerjes së akteve noteriale është shprehja e lirë e vullnetit mbi llojin e veprimit juridik dhe parashikimin e pasojave në zgjedhjen e këtij veprimi juridik. Kjo do të thotë se element i rëndësishëm i aktit noterial është konfirmimi i shfaqjes së ligjshme të vullnetit të personit që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile. Trupi gjykues vlerëson se, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, dhe jo mënyra e kryerjes së pagesave dhe mënyra e ekzekutimit të detyrimit, në rastin konkret, përcaktimi i faktit se cili ishte personi që ka dorëzuar fizikisht shumën e huas subjektit të rivlerësimit, kunati apo i atit i kunatit. Rëndësi ka, për qëllime të rivlerësimit, që i rivlerësuarit të ketë deklaruar rregullisht marrëdhënien e huas, sipas procedurës së parashikuar me ligj.

Dorëzimi i shumës së huamarrjes së rënë dakord midis subjektit të rivlerësimit dhe kunatit të tij me banim të rregullt në Itali është bërë nga ana e babait të kunatit të subjektit të rivlerësimit, por titullar dhe kreditor i shumës së huas është kunati i subjektit të rivlerësimit, z. E. C. Duke qenë se deklarata noteriale nuk ka natyrë konstitutive dhe ndodhemi përpara një marrëdhënieje të posaçme midis subjektit të rivlerësimit dhe kunatit, shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit janë bindëse për të arritur në përfundimin se shuma e huas është rënë dakord midis tij dhe kunatit të tij, por është dorëzuar nga ana e të atit të kunatit, z. P. C., në dorë të subjektit të rivlerësimit. Ky fakt provohet nga deklarata e z. P. C., i cili konfirmon faktin e dorëzimit të shumës së rënë dakord më parë midis djalit të tij dhe subjektit të rivlerësimit, si edhe faktin se djali i tij i ka dërguar mesatarisht 6 - 7 mijë euro në vit, që vërtetojnë se ai ka pasur burime të ardhurash për të dhënë hua.

Në lidhje me aftësinë paguese të kunatit të subjektit të rivlerësimit, z. E. C., trupi gjykues vlerëson se, siç është përmendur dhe më lart, kunati i subjektit të rivlerësimit që nga viti 2002 e në vijim nuk ndodhet në Shqipëri, duke qëndruar në Itali me gjithë familjen e tij. Në këtë shtet, ai ka realizuar të ardhura nga puna dhe kursimet e tij. Meqenëse ai ndodhet jashtë, ligji i zbatueshëm për zbatimin e tatimeve dhe realizimin e të ardhurave është ligji i shtetit ku janë realizuar ato të

ardhura. Gjithsesi, për të ardhurat nga puna të marra me para në dorë, detyrimi për pagimin e tatimit qëndron për punëdhënësin dhe jo për punëmarrësin. Sipas ligjit italian, të gjitha të ardhurat për të cilat nuk janë deklaruar tatime, nuk janë të ardhura të paligjshme dhe për to duhet të paguhet tatimi përkatës. Trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se kunati i subjektit të rivlerësimit, z. E. C., nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i deklarimit të të ardhurave, prandaj parashikimi i përcaktimit kushtetues, i nenit D, pika 3, fjalia e dytë, që i konsideron si të ligjshme vetëm ato të ardhura që janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore, nuk gjen zbatim ndaj këtij individi, për arsye se: së pari, ai nuk ka realizuar të ardhura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, ai nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i deklarimit të pasurive, nuk ka kryer ndonjëherë funksion zyrtar që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë. Sa i përket faktit të përcaktimit të aftësisë paguese të kunatit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, nisur nga një periudhë relativisht e gjatë, nga viti 2002 deri në vitin 2013, kur i ka dhënë huan e sipërpërmendur, pra për një periudhë 10-vjeçare, z. E. C. mund të kursente të paktën shumën prej 1.000 eurosh për çdo vit, duke i dhënë ato hua pa kundërshtim për subjektin e rivlerësimit.

Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse për origjinën e shumës së huas së sipërpërmendur.

- Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.
- Kunati ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën e sipërpërmendur.

❖ Hua në vlerën 15.000 euro, marrë vëllait M. D., me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2014.

- Rezulton se nuk provoni me dokumentacion justifikues aftësinë paguese të z. M. D., për dhënien e kësaj huaje.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vëllai i tij, z. M. D., është emigrant ekonomik në Greqi, nga viti 1993 e në vazhdim. Nga viti 1993 deri në vitin 1998, ai ka qenë pa dokumente të rregullta emigrimi (emigrant i paligjshëm). Fakti që ka qenë emigrant, vërtetohet nga Njësia Administrative Luzni, nëpërmjet një shkrese zyrtare, e cila ndodhet në fashikullin e provave. Duke punuar në emigracion, ai ka krijuar të ardhura të cilat i ka sjellë në Shqipëri, pavarësisht se nuk disponon dokument zyrtar për këtë. Duke iu referuar situatës në Shqipëri, pas vitit 1990, është një fakt që dihet tashmë se mbi 70 % e familjeve shqiptare kishin të paktën një person në emigracion, pa dokumente, në vende të ndryshme, si Greqi, Itali, Gjermani, Francë, etj. Ishin pikërisht të ardhurat e këtyre emigrantëve të paligjshëm që mbanin familjet e tyre në Shqipëri.

Arsyetimi ligjor

Sa i përket aftësisë paguese të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. M. D., i cili ka pretenduar se ka realizuar të ardhura në Greqi, pasi ka qenë rezident në atë vend, trupi gjykues vlerëson se është i zbatueshëm ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Meqenëse të ardhurat nga paga e vëllait të subjektit janë realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e kuptueshme që vëllai i subjektit nuk kishte ndonjë detyrim për të deklaruar të ardhurat e realizuara në shtetin grek, dhe rrjedhimisht nuk shihet ndonjë shkak që këto të ardhura të realizuara nga vëllai i subjektit deri në vitin 2014 të konsiderohen si të ardhura të paligjshme. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, rezulton e provuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga puna dhe kursimet e tij, së bashku me familjen, në shtetin grek. Referuar deklarameteve të bëra nga vëllai, vërehet se ai ka fituar para nga puna e tij si emigrant, e provuar kjo edhe me deklarametet e punëdhënësit në shtetin grek, të cilat justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave. Meqenëse ai ndodhet jashtë, ligji i zbatueshëm për tatimet dhe realizimin e të ardhurave është ligji i shtetit ku janë realizuar ato të ardhura. Gjithsesi, për të ardhurat nga puna, të marra me para në dorë, detyrimi për pagimin e tatimit qëndron për punëdhënësin dhe jo për punëmarrësin. Sipas legjislacionit të shtetit përkatës, të gjitha të ardhurat për të cilat nuk janë deklaruar tatime nuk janë të ardhura të paligjshme dhe për to duhet të paguhet tatimi përkatës. Trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se i vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. M. D., nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i deklarimit të të ardhurave, prandaj parashikimi i përcaktimit kushtetues, i nenit D, pika 3, fjalia e dytë, që i konsideron si të ligjshme vetëm ato të ardhura që janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore, nuk gjen zbatim ndaj këtij individi, për arsye se: së pari, ai nuk ka realizuar të ardhura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, ai nuk qenë ndonjëherë subjekt i deklarimit të pasurive dhe nuk ka kryer ndonjëherë ndonjë funksion zyrtar që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë.

Sa i përket faktit të përcaktimit të aftësisë paguese të vëllait të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, nisur nga një periudhë relativisht e gjatë, nga viti 1993 deri në vitin 2013, kur i ka dhënë huan e sipërpërmendur, pra për një periudhë 20-vjeçare z. M. D., mund të kursente të paktën shumën prej 1.000 eurosh, për çdo vit, duke i dhënë ato hua pa kundërshtim për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim të analizës së mësipërme, konstatohet se:

- Vëllai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën e sipërpërmendur.

Lidhur me përcaktimet e parashikuara në nenin D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, referuar konceptit të pasurisë së ligjshme për qëllime të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se dispozita i referohet subjektit të rivlerësimit dhe, në rastin në fjalë, huaja e marrë është një detyrim, i cili do të zëvendësohet nga subjekti i rivlerësimit, me kthimin e saj, me të ardhurat e vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat duhet të jenë sipas përcaktimeve të kësaj dispozite. Vetëm me shlyerjen e huas dhe kredisë bankare, prona do të jetë e subjektit të rivlerësimit dhe burimi i krijimit të saj duhet të jetë nga të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

4. Apartament, në Golem, në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit

*Subjekti rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ka deklaruar se ka përdorur një apartament dhomë e kuzhinë në pronësi të vëllait, z. L. D., të ndodhur te ***, në Golem, Kavajë.*

Bazuar në shkresën e OSHEE-së, nr. 26409/1., datë 29.12.2017, rezulton se subjekti ka kontratë furnizimi energjie elektrike me OSHEE-në për një apartament në Golem, adresa e të cilit lidhet me apartamentin në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. L. D.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupi gjykues vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës subjektit për këtë pasuri.

Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

❖ Në lidhje me apartamentin në Golem, që deklaroni se keni në përdorim, i cili rezulton në pronësi të vëllait tuaj.

Rezulton se:

1. Bazuar në shkresën nr. ***, datë 29.12.2017, të OSHEE-së, kontrata e furnizimi të energjisë elektrike është në emrin tuaj dhe energjia elektrike është paguar vetëm nga ana juaj.
2. Vëllai juaj, z. L. D., nuk rezulton se ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ai nuk ka deklaruar se ka apartament në përdorim, por ka thënë, -për të qenë sa më transparent -se e ka përdorur ndonjëherë, me ditë, gjatë pushimeve të verës. Kjo shprehje nuk nënkupton se ka pasur një marrëdhënie juridike të tillë, për përdorimin sendit, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

Në referim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ku përcaktohet se: “4. *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*”, vëllai nuk konsiderohet në këtë rast person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi nuk ka cilësinë e huamarrësit, huadhënësit, dhuruesit, të ndonjë pasurie, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, që rregullojnë këto marrëdhënie juridike. Duhet theksuar dhe fakti se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. L. D., nga viti 1991 nuk bën pjesë në trungun familjar të familjes së subjektit të rivlerësimit. Ky apartament është blerë me kontratë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe është regjistruar në ZVRPP në emër të tij. Këtë pronë e posedon dhe e administron vëllai i tij, së bashku me familjen e tij. Prona është e regjistruar vetëm në emër të pronarit dhe i vetmi dokument zyrtar që vërteton pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme është certifikata e pronësisë e lëshuar nga ZVRPP-ja. Certifikata e pronësisë për apartamentin e mësipërm është lëshuar në emër të z. L. D., dhe askujt tjetër. Ai është pronari “origjinal” dhe i vetëm i pronës, pasi rrjedh direkt nga ndërtuesi dhe nuk e ka të prejdardhur pronën me veprime të tjera juridike. Subjekti thjesht e ka përdorur disa herë këtë apartament gjatë

pushimeve të verës, nuk ka asnjë kontratë qiraje për këtë pronë. Në këtë kuptim, veprimi juridik i “përdorimit të sendit”, që parashikojnë dispozitat përkatëse të Kodit Civil, nuk ekziston.

Pagesa e energjisë apo librezja e energjisë elektrike nuk vërteton pronësinë e banesës, por faktin që për këtë apartament është paguar energjia elektrike, të cilën mund ta paguajë edhe jo pronari, si qiramarrësi, personi që përkujdeset apo e ka në ruajtje banesën. Pronësinë e vërteton, sipas ligjit, kontrata e blerjes (apo mënyrë tjetër e fitimit të pronësisë) dhe regjistrimi hipotekor. Çelja e librezës së energjisë elektrike në emrin tim është bërë me kërkesë të vëllait, meqenëse në atë kohë unë punoja në Durrës dhe vëllai banonte në Dibër.

Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues vlerëson se pasuria e mësipërme është në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. L. D. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka përdorur ndonjëherë gjatë pushimeve të verës këtë pronë të vëllait të tij dhe familjes së tij. E vetmja gjetje që ekziston ndaj subjektit të rivlerësimit është se ai ka marrë përsipër të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e energjisë e kësaj pasurie, që është e regjistruar në emër të vëllait të tij. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur ndonjë të drejtë reale, siç është ajo e përdorimit mbi pasurinë që zotërohet dhe administrohet nga pronari i saj. Fakti që këtë pasuri e ka përdorur vetëm për një periudhë të caktuar edhe subjekti i rivlerësimit, nuk do të thotë se mbajtja e sendit përkohësisht, që i përket vëllait, është një e drejtë reale, siç është ajo e përdorimit të sendit për vete. Sa i takon marrjes përsipër nga ana e subjektit për të paguar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e furnizimit me energji elektrike, nisur nga rrethanat e rastit konkret, trupi gjykues nuk e konsideron këtë fakt si një indice që nënkupton pasurinë e fshehur të një subjekti rivlerësimi, por si një veprim juridik që korrespondon me kontratën e porosisë. Në bazë të nenit 913 të Kodit Civil, porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër. Kjo lloj kontrate nuk lejon posedimin e sendit të paluajtshëm, por delegimin e të porositurit vetëm për pagesën e detyrimeve të kontratës së furnizimit me energji elektrike të pronës që i përket porositësit, që është edhe vëllai i subjektit të rivlerësimit. Në tilla kushte, përderisa subjekti i rivlerësimit nuk ka një marrëdhënie huaje, dhurimi, atëherë i porosituri nuk mund të cilësohet si një person tjetër i lidhur për të justifikuar pasurinë mbi të cilën është zbatuar një kontratë porosie, në mungesë të indiceve të forta dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën, që hedhin dritë mbi posedimin dhe zotërimin e sendit nga subjekti i rivlerësimit. Por për arsye të kësaj marrëdhënieje të krijuar, trupi gjykues gjen me vend kërkesën e bërë për burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie. Po ashtu, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se vëllai i tij ka pasur në mënyrë të vazhduar të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria, blegtoria, bletaria, ku figuron i regjistruar dhe në regjistrin e fermerëve, u dukën bindëse. Subjekti sqaroi se vëllai i tij, së bashku me familjen, kanë punuar në bujqësi, pemëtari, blegtori dhe bletari, fakt ky që provohet edhe nga disponimi i tokës bujqësore në atë zonë nga vëllai i tij, konkretisht (1) tokë arë 7.312 m², (2) 1.652 m² tokë (1.402 m² tokë arë dhe 250 m² truall), të përfituara në emër të babait, por që i ka në përdorim z. L. D., (3) rreth 5.000 m² livadhe dhe sipërfaqe pyjore. Subjekti gjithashtu shpjegoi se të ardhurat e familjes së vëllait, z. L. D., vijnë

nga puna në prodhimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, të produkteve blegtorale, rritjen e bletëve dhe shitjen e produkteve të tyre, mbledhjen dhe shitjen e bimëve medicinale, si dhe prodhimin dhe shitjen e frutave dhe perimeve. Znj. D. D., ka derdhur kontribute si e vetëpunësuar (fermere) në aktivitetin familjar.

Në shqyrtim të rastit konkret, në bazë të dokumentacionit shkresor, në shqyrtim edhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se nuk kishte dyshime të bazuara se subjekti i rivlerësimit mund të ketë bërë fshehje pasurie dhe se kjo pasuri të jetë realisht e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues krijoi bindjen se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta blerë këtë banesë dhe se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur atë mbështetur në një marrëdhënie familjare të shëndoshë që ata kanë.

- Nga analiza e dokumentacionit rezulton se subjekti ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklarinimin e tij.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarinimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit;
- 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë. Në lidhje me këtë seksion, nga ana e Komisionit i është dërguar shkresë KLD-së me nr. *** prot., datë 29.01.2018, duke kërkuar informacion mbi z. Bashkim Dedja. Me shkresën nr. *** prot., datë 06.03.2018, KLD-ja na informon se për z. Bashkim Dedja, për periudhën janar 2006 deri më sot, nga kërkimet e deritanishme në zyrën e arkiv/protokollit të KLD-së disponohen 4 ankesa. Nga këto ankesa, vetëm 3 janë hetuar nga KLD-ja, ku është konkluduar se nuk janë konstatuar shkelje të ligjit në mënyrë të atillë, që të përbënin shkelje disipline në kuptim të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti, në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ka njohuri të gjera ligjore, të cilat konstatohet se përfshijnë njohuri të së drejtës kushtetuese, të së drejtës ndërkombëtare, gjer te ligjet e brendshme. Ai ka njohuri edhe të çështjeve që lidhen me grupet në nevojë, siç janë të verbrit.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën kushtetuese të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ai i njeh mirë çështjet procedurale në funksion të zgjidhjes së saktë të themelit të çështjes, ku rëndësi u kushton kriterëve formale të pranimin për shqyrtim të çështjes, siç janë legjitimiteti i kërkuesit në të gjithë komponentët e tij, elementet formale të mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushtetit qendror dhe atij vendor, apo edhe juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, ku në një rast ka arsyetuar pro juridiksionit kushtetues, pavarësisht natyrës së aktit administrativ.

Gjithashtu, ai tregon kujdes për identifikimin e koncepteve kyçe të çështjes dhe për nxjerrjen e përmbajtjes së saktë të tyre, ai përdor metodën e interpretimit krahasimor në kontekstin historik të saj apo edhe metodën e interpretimit krahasimor me legjisllacionin ndërkombëtar, ku norma ligjore është huazuar. Në të gjitha rastet, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për çështjen dhe për të ruajtur koherencën në vendimmarrje, ai përdor referenca në jurisprudencën e vetë Gjykatës Kushtetuese, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese gjermane, kur është rasti, ai përdor edhe

referenca në praktikën e GJEDNJ-së, si dhe në legjislacionin e BE-së (në konventat ndërkombëtare apo në legjislacione të vendeve të ndryshme).

Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ka aftësi të dukshme në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta, të kuptueshme, të organizuara sipas një metodologjie të caktuar me nënpjesë. Gjyqtari i kushton rëndësi identifikimit të pretendimeve të palëve, duke i listuar ato të përmbledhura. Në arsyetimin e vendimit, ai fillimisht analizon çështjet procedurale, kryesisht elementet e legjitimitetit të kërkuarit dhe të juridiksionit kushtetues, për të vijuar më pas me pretendimet e themelit të mosmarrëveshjes. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës kushtetuese përballë normës ligjore që kundërshtohet. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara, edhe kur është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Bën ndarje të qartë të çështjeve me tituj dhe paragrafë të numërtuar, që lehtëson leximin dhe shfrytëzimin e vendimit. Përdor saktë teknikat e referencës, duke përfshirë edhe shënimet në fund të faqes për të mos rënduar tekstin e vendimit.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv në drejtim të përfundimit të çështjeve në raport me numrin e çështjeve që atij i caktohen. Në asnjë rast, nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk është dokumentuar të ketë pasur vonesë të shkaktuar nga anëtarët e trupit gjykues në nënshkrimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara nga relatori Bashkim Dedja. Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Vihet re dokumentimi i çdo veprimi gjyqësor/administrativ, si dhe mbajtja e procesverbalit në seancë plenare të nënshkruar rregullisht nga kryesuesi i seancës dhe sekretari që e mban atë

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve pa vonesa nga sekretaria gjyqësore, pasi nuk ka pasur raste që seanca të dështonte për shkak të mosnjoftimit të palëve.

Gjithashtu, vihet re se subjekti i rivlerësimit ka kryer të gjitha veprimet për përgatitjen e çështjes për vendimmarrje, sipas kërkesave të ligjit.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në të gjitha rastet, dosjet kanë inventarizim të akteve, ndërsa rezulton se dhe aktet e njoftimit janë të plota për secilën dosje. Gjithashtu, vihet re dërgimi i vendimit përfundimtar të Gjykatës Ministrisë së Drejtësisë për botimin e tij në Fletoren Zyrtare. Në 5 dosjet e vëzhguara ndodhet relacioni i ndihmësit ligjor, i cili kishte datë hartimi, por jo nënshkrim të tij. Në një rast, data në procesverbalin mbi shqyrtimin e kërkesës për pezullim nga Mbledhja e Gjyqtarëve me relator gjyqtarin Bashkim Dedja, rezulton të jetë lapsus (shih dosjen nr. 1), ndërsa në një rast tjetër procesverbali i votimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për vendimin përfundimtar nuk ka datë (shih dosjen nr. 3).

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt dhe verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna për ndikim apo presion të jashtëm.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Mënyra e komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse ka qenë normale. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Në 3 dosje është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar vonesë në shpalljen e vendimit. Në dy raste ky bashkëpunim ka qenë shumë i mirë, pasi vendimi është shpallur i arsyetuar brenda dy ditëve nga votimi, ndërsa theksohet se në të dy këto raste është disponuar me vendim moskalimi të çështjes për shqyrtim në seancë.

Në të 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara vihet re një bashkëveprim i mirë i subjektit me administratën gjyqësore, pasi në asnjë rast nuk janë konstatuar vonesa në komunikimin e akteve nga administrata gjyqësore, me pasoja për vetë procesin gjyqësor apo dhe komunikimin e vendimeve përfundimtare të gjykatës.

Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, për shkak të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit kushtetues, nuk përfshihet në programet e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërsa është vetëtrajnuar pranë Shkollës së Magjistraturës.

Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 13 qershor 2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

VALBONA SANXHAKTARI

Kryesues

XHENSILA PINE

Relator
Kundër

ROLAND ILIA

Relator

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj

MENDIM PAKICE

Si relatore e trupës gjyquese, nuk pajtohem me përfundimin e arritur nga ana e shumicës në rastin e shqyrtimit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, për arsyet si vijon:

1. Për apartamentin e banimit me sipërfaqe 146.14 m² dhe garazhin me sipërfaqe 15.25 m², me vlerë 180.000 euro, me adresë: Njësia Nr. ***, Rr. “***”, P. “***”, Tiranë.

Burimi i deklaruar në Deklaratën - Vetting:

- *Kredi bankare në vlerën 120.000 euro (ose 16.800.000 lekë) nga “BKT”, me afat shlyerjeje 20 vjet;*
- *Hua pa interes, në vlerën totale 25.000 euro;*
- *Të ardhura personale dhe të bashkëshortes, në vlerën 35.000 euro.*

1.1 Në lidhje me huan në vlerën 10.000 euro, marrë kunatit, z. E. C.

Si burim i deklaruar në Deklaratën - Vetting, rezultoi se:

1.1.1 Bazuar në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2014, më datë 10.10.2013, z. E. C., i ka dhënë hua z. Bashkim Dedja shumë prej 10.000 eurosh.

1.1.2 Në datën e specifikuar në kontratën noteriale, si data e dhënies së huas, 10.10.2013, z. E. C., nuk ka qenë në Shqipëri, sipas konfirmimit të shkresës nr. *** prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

1.1.3. Në lidhje me këtë pikë, subjektit iu kërkuan sqarime. Në kthimin e përgjigjes, subjekti deklaroi se data e saktë e marrjes së huas nuk i kujtohet, nëse është ajo që është shënuar në deklaratën noteriale, apo jo.

1.1.4 Neni 40 i ligjit për noterinë përcakton se “***Aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike***”.

1.1.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion provues për të ardhurat e siguruara nga kunati i tij për të justifikuar shumë prej 10.000 eurosh, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, në të cilin parashikohet se: “*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj*”.

Sa më sipër, iu kalua barra e provës se, për sa kohë nuk është dorëzuar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të siguruara nga kunati i tij, z. E. C., ai duket se nuk justifikon me dokumentacion ligjor të ardhurat e huas në shumë prej 10.000 euro.

Shpjegimet e subjektit për këtë barrë prove ishin si më poshtë:

1.1.6 Këtë hua e kishte marrë nga kunati, E. C., jo drejtpërdrejt prej tij, por nga babai tij, P. C., dhe më pas ka bërë deklaratën noteriale me E. C.

1.1.7 Duke qenë se kishte planifikuar për të blerë shtëpi dhe kishte hyrë në negociata me shoqërinë ndërtuese “***” dhe kishte nevojë për të ardhura shtesë -pasi, si rregull, për marrjen e kredisë paguhej 30 % e shumës, e cila duhej mbuluar nga ai dhe 70 % nga banka nëpërmjet kredisë, -për këtë bisedoi me vjehrrin dhe ra dakord që ai t’ia merrte këto para të djalit të tij, E., në vlerën prej 10.000 eurosh.

1.1.8 E. C. ka qenë emigrant në Itali nga viti 2002 e në vazhdim dhe ka qenë në një trung familjar më babain e tij, z. P. C., deri në shtator të vitit 2017, kur është shkëputur duke krijuar familje më vete. Gjatë kohës që kanë qenë bashkë në një trung familjar, z. E. C., ka sjellë mesatarisht çdo vit rreth 6 - 7 mijë euro. Në kohën që ai ka marrë huan, në vitin 2013, E. ka qenë në një trung familjar me P.

1.1.9 Në lidhje me dorëzimin e parave, z. P. C., ka bërë dhe një deklaratë noteriale, nr. *** rep., datë 13.04.2018, që u kërkua të merret si provë dhe u administrua dhe analizua nga Komisioni.

1.1.10 Z. E. C., për periudhën e qenies emigrant në Itali, nga viti 2002 e në vazhdim, ka paraqitur një pjesë të dokumenteve që vërtetojnë burimin e të ardhurave të tij. Siç ka deklaruar E., një pjesë të madhe të kohës ka punuar dhe është paguar me para *cash* dhe jo nëpërmjet bankës. Për këtë mungon dokumentacioni provues i të ardhurave apo pagesat, pasi punëdhënësit nuk kanë qenë të gatshëm të lëshojnë vërtetime për këtë fakt.

1.1.12 Në lidhje me pretendimin se ai si subjekt i rivlerësimit e dinte se paratë që po i jepte kunati nuk ishin siguruar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ishin paguar taksat, ai deklaron se paratë që ka përfituar E. në emigracion nga puna e ndershme, si mijëra shqiptarë të tjerë, që kanë qenë pa dokumente, nuk mund të konsiderohen si para të përfituara në mënyrë të paligjshme, pasi puna që ka kryer provohet me dokumentet që ai ka sjellë. Kurse për pagimin e taksave në vendin fqinj, Itali, as nuk e ka pyetur dhe as nuk i ka thënë ndonjëherë për këtë fakt. Për informacionin që lidhet me konstatimin se *“Kunati ka punuar pa kontratë të rregullt punësimi, dhe këto para nuk ishin siguruar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ishin paguar taksat”*, subjekti i rivlerësimit deklaron se është vënë në dijeni në kohën që ka filluar procesi administrativ i vetting-ut, kurse huaja është marrë shumë vite më parë.

Analiza e provave

1.1.13 Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2014, më datë 10.10.2013, sipas së cilës z. E. C., i ka dhënë hua z. Bashkim Dedja shumë prej 10.000 eurosh, bie ndesh me parashikimet ligjore të nenit 40 të ligjit për noterinë.

1.1.14 Nga ana e subjektit është depozituar deklaratë tjetër noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.04.2018, nëpërmjet së cilës z. P. C., deklaron se për çdo vit, i biri i tij i ka dërguar si kryefamiljar shumë 6.000 - 7.000 euro. Në tetor të vitit 2013, pasi është konsultuar me të birin,

nga kursimet e tyre familjare i ka dhënë z. Bashkim Dedja një hua në vlerën 10.000 euro, të cilat ia ka dhënë në dorë.

1.1.15 Kjo deklaratë e dytë noteriale nuk është në përputhje me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.03.2014, të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit si dokumentacion provues në Deklaratën -Vetting, në të cilën ai deklaron se më datë 10.10.2013, i ka marrë hua z. E. C.,shumën prej 10.000 eurosh.

1.1.16 Deklarata noteriale e z. P. C., nuk mund të merret në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit i ka pasur të gjitha mundësitë që në Deklaratën - Vetting të shpjegonte faktin që shumën prej 10.000 eurosh e ka marrë hua nga të ardhurat familjare të z .P. C.

1.1.17 Bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pika 3, dhe në nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016, *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*. Pra, në Deklaratën - Vetting të depozitonte të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë.

1.1.18 Nga ana e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me këtë hua, në Deklaratën - Vetting është deklaruar që ia ka marrë z. E. C., dhe ka ndryshuar deklarim vetëm pasi nga ana e Komisionit është konstatuar se z. E. C., nuk ka qenë në Shqipëri më datë 10.10.2013. Pra, subjekti i rivlerësimit, me qëllim shmangien nga ky deklarim i rremë i tij, ka depozituar deklaratën noteriale të z. P. C., e cila nuk është në përputhje me deklaratimet e tij në Deklaratën -Vetting, por dhe në deklaratën periodike të vitit 2013.

1.1.19 Rezulton se jemi në kushtet e deklarimit të rremë nga ana e subjektit i rivlerësimit, pasi ai në Deklaratën - Vetting deklaron se shumën 10.000 euro ia ka marrë hua z. E. C., ndërsa ndryshon deklarimin, duke u shprehur se kjo shumë i është dhënë nga ana e vjehrrit të tij.

1.1.20 Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur lidhur me të ardhurat e realizuara nga kunati, z. E. C.:

1. Dokumenti i parë është "Dichiarazione sostitutiva CUD", një deklaratë e bërë më 10 shkurt 2018 nga punëdhënësi (z. A. V.), që vërteton se nga data 01.01.2012 deri më 31.12.2012, shuma prej 11.450 eurosh i është paguar E. C., për "lavoro domestico" (punë shtëpie). Dokumenti i lartpërmendur:

- a) Duhet të ishte bërë, sipas legjislacionit italian, në vitin 2013 (para datës së pagimit të taksave në Itali për periudhën 2012) dhe jo më 10 shkurt 2018;
- b) Dokumenti nuk përmban të gjitha fushat, që zakonisht përmbajnë "Dichiarazione sostitutiva CUD" (p.sh. "TFR", kontributet e pensionit të paguara nga punonjësi etj.);
- c) Nuk mund të konsiderohet vetëdeklarim, sepse duket se paraqitet nga një palë e tretë (z. A. V.);
- d) Në çdo rast, firma e z. A. V., nuk është vërtetuar dhe nuk mund të konsiderohet si e vlefshme.

- **Si rezultat, dokumenti në fjalë nuk mund të merret në konsideratë, pasi nuk ka ndonjë vlerë provuese.**

1.1.21 Dokumenti i dytë, "-7-DOC-EKSTRAKT", thotë se nga 14.02.2012 deri më 31.12.2012, z. E. C., kishte kontribute të paguara për 260 ditë pune të supozuar në bujqësi (jo punë shtëpiake, siç referohej në dokumentin e mëparshëm), që korrespondon me të ardhura prej 10.761 eurosh.

Megjithatë, dokumenti në fjalë përmban një vulë, që thotë: "Kjo certifikatë nuk mund t'u paraqitet autoriteteve publike ose subjekteve private që ofrojnë shërbime publike [...]".

- **Si rezultat, dokumenti në fjalë nuk mund të merret në konsideratë, pasi nuk ka ndonjë vlerë provuese.**

1.1.22 Informacioni i dërguar përfshin të ardhurat e realizuara për periudhën 2003 - 2013, por në të nuk janë paraqitur të dhëna për numrin e personave bashkëjetues, arsimit, kushtet e banimit, vlerat e qirasë, shpenzimet e tjera, udhëtime të mundshme etj., shpenzime këto që ndikojnë në shumën e kursimeve.

Arsyetimi ligjor

1.1.23 Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën - Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe avokati i tij gjatë seancës dëgjimore, arrij në përfundimin se:

- i) Z. E. C., nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit, prej 10.000 eurosh, sipas nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit "*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre*".
- ii) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të rremë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurisë në Deklaratën - Vetting.

1.2 Në lidhje me huan në vlerën 15.000 euro, marrë vëllait, z. M. D.

Si burim i deklaruar në Deklaratën - Vetting rezultoi se:

1.2.1 Bazuar në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2014, rezulton se më datë 22.08.2013, z. M. D., i ka dhënë z. Bashkim Dedja shumën prej 15.000 eurosh hua.

1.2.2 Bazuar në nenin D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se: "*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të*

cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

1.2.3 Subjektit iu kalua barra e provës se, për sa kohë nuk është dorëzuar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të siguruara nga vëllai i tij, ai duket se nuk justifikon me dokumentacion ligjor të ardhurat e huas në shumën 15.000 euro. Shpjegimet e subjektit për këtë barrë prove ishin si më poshtë:

1.2.4 Këtë hua e kishte marrë nga vëllai, M. D., drejtpërdrejt prej tij, në para *cash*, në kohën që ai ka qenë në Tiranë me pushime. M., është emigrant në Greqi që nga viti 1993 dhe deri në vitin 1998 ka qenë emigrant i palegalizuar, si gjithë shqiptarët që u larguan pas vitit 1990.

1.2.5 Nga viti 1998 e në vazhdim ai është emigrant me dokumente të rregullta, siç është paraqitur në dokumentin përkatës. Ai ka paraqitur dokumente që vërtetojnë një pjesë të të ardhurave që ka marrë ndër vite bashkë me bashkëshorten, V., pasi, siç më ka shpjeguar, jo vetëm kur pagesat janë bërë *cash*, në dorë, mungon dokumenti, por edhe kur janë bërë me bankë, për arsyet e tyre, punëdhënësit pjesërisht i paguanin me bankë dhe pjesën tjetër të pagesës ua bënin në dorë, me pagesa *cash*.

1.2.6 Në lidhje me paratë e marra borxh nga vëllai, z. M. D., beson se paratë që ka përfituar vëllai në emigracion në Greqi, nga puna e ndershme, si mijëra shqiptarë të tjerë që kanë qenë pa dokumente, nuk mund të konsiderohen si para të përfituara në mënyrë të paligjshme, pasi puna që ka kryer provohet me dokumentet që ai ka sjellë. Kurse për pagimin e taksave në vendin fqinj, në Greqi, as nuk e ka pyetur dhe as nuk i ka thënë ndonjëherë për këtë fakt.

1.2.7 Informacioni që lidhet me pretendimin se “*vëllai ka punuar pa kontratë të rregullt punësimi dhe se këto para nuk ishin fituar në mënyrë të ligjshme, duke mos paguar taksa*”, sqaron se është vënë në dijeni në kohën kur ka filluar procesi administrativ i vetting-ut, kurse huaja është marrë shumë vite më parë.

1.2.8 M., i ka shpjeguar se ai ka bërë edhe punë të dyta sezonale në bujqësi e pemëtari, bashkë me bashkëshorten, punë të ndryshme në punime, vjelje, shitje ullinjsh, agrumesh, etj., krahas punës kryesore në serra. Nga këto punë kanë siguruar të ardhura, por që nuk kanë dokumente provuese, pasi punëdhënësit nuk i deklarojnë të gjithë punonjësit sezonalë dhe i paguajnë me para në dorë, *cash*, këto janë fakte që dihen botërisht. Prandaj, M., ka pasur burime të ardhurash dhe e justifikon huan e dhënë.

Analiza e provave

1.2.9 Bazuar në vërtetimin nën betim nr. *******, të datës 16.02.2018, të shtetasit E. V., bujk, i cili deklaroi se ka një kompani në Vlacherna, në Artë, me objekt prodhimin e fidanëve të agrumeve, ullinj, kivi, shëgë dhe vreshta. Në këtë kompani ka punësuar që nga vitit 1998 z. M. D., dhe nga 01.06.2003, znj. V. D. Paga mujore për z. M. D., ka qenë nga 1.03.1998 - 31.12.2001 në shumën 733.68 euro dhe nga 1.01.2002 e në vazhdim ka qenë 850 euro. Paga mujore për znj. V. D., nga 01.06.2003 e deri më sot, ka qenë 850 euro. Përveç pagës mujore, ata kanë qenë të punësuar dhe për shartimin e bimëve dhe kanë marrë si pagesë 0.15 cent euro për bimë. Së bashku, ata kanë shartuar 60.000 bimë çdo vit.

1.2.10 Nuk është depozituar asnjë dokument shtetëror për të vërtetuar se nga ana e shtetasit M. D., punësimi i tij ka qenë i rregulluar sipas legjislacionit grek.

1.2.11 Nga vërtetimi nr. *** prot., i datës 13.04.2018, i Ministrisë së Punës dhe Sigurimeve Shoqërore, Organizimi i punësimit i fuqisë punëtore, rezulton se z. M. D., ka pasur kartë jeshile për vitet 1999 - 2001.

1.2.12 Nga vërtetimi nr. *** prot., datë 12.04.2018, i Administratës së Centralizuar të Epirit-Maqedonia Perëndimore, Drejtoria e Përgjithshme e Funksionimit të Brendshëm, Drejtoria e të Huajve dhe Emigracionit, Sektori i Lejeve të Qëndrimit Artë, rezulton se z. M. D., ka leje rezidence për vitet 15.04.2002 - 03.09.2024.

1.2.13 Nga vërtetimi nr. *** prot., datë 12.04.2018, i Administratës së Centralizuar të Epirit-Maqedonia Perëndimore, Drejtoria e Përgjithshme e Funksionimit të Brendshëm, Drejtoria e të Huajve dhe Emigracionit, Sektori i Lejeve të Qëndrimit Artë, rezulton se znj. V. D., ka leje rezidence për vitet 05.11.2001 - 14.04.2019.

1.2.14 Z. M. D., dhe znj. V. D., janë emigrantë të rregullt në Greqi dhe, si të tillë, nuk kishte arsye se pse të mos punonin konform rregullave të parashikuara nga ana e legjislacionit grek.

1.2.15 Nga subjekti i rivlerësimit nuk është dorëzuar asnjë dokument shtetëror për të provuar të ardhurat e ligjshme të krijuara nga ana e familjes së vëllait të tij në shtetin grek. Subjekti ka depozituar vetëm një deklaratë noteriale të një shtetasi grek, por që nuk mund të shërbejë si provë për të vërtetuar të ardhurat e vëllait të tij, nëse nuk është e shoqëruar me dokumente shtetërore të lëshuara nga institucionet përkatëse të shtetit grek. Nuk është depozituar asnjë dokumentacion për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore në shtetin grek apo shtetin shqiptar, si dhe nuk është depozituar asnjë dokumentacion shtetëror për të dokumentuar deklarinimin si punonjës të z. M. D., dhe znj. V. D.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se vëllai i tij, z. M. D., përveçse i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 15.000 euro, ka kryer shpenzime të konsiderueshme në blerje të pasurisë së paluajtshme, si më poshtë:

- Një apartament në Tiranë, me vlerë 42.000 euro, në vitin 2014 (bllokuar nga “Alpha Bank” për shumën e marrë hua 25.000 euro, sipas kartelës së pasurisë së apartamentit);
- Një sipërfaqe toke, 2000 m², në Durrës, në vitin 2003, në bashkëpronësi me vëllain L. D., me vlerë 900.000 lekë.

1.2.16 Sipas deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, rezultoi gjithashtu se z. M. D.:

- Ka kontribuar në blerjen e shtëpisë të vëllait, L. D., në Golem.
- Në blerjen e shtëpisë së vetë subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, në rrugën “***”.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën - Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike, (iii) provat shkresore të administruara nga

Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe avokati i tij gjatë seancës dëgjimore, arrij në përfundimin se:

- i) Z. M. D., nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit prej 15.000 eurosh, sipas nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre”*.

2. Në lidhje me apartament banimi, me sipërfaqe 98 m², me vlerë 19.600 USD ose (1.812.020 lekë) në Njësinë Nr. ***, Rr. “***”, pallati ***, sh. ***, fituar me kontratën e sipërmarrjes, datë 09.01.1997, dhe kontratë shitjeje, datë 21.08.2007, me nr. *** rep., nr. *** kol.

Burimi i krijimit sipas Deklaratës - Vetting: *Kursimet dhe të ardhurat*.

2.1 Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit rezultoi se:

2.1.1 Nga verifikimi i deklaratës fillestare të interesave private të vitit 2003 rezulton se ka mospërputhje midis këtij deklarimi dhe Deklaratës- Vetting për këtë pasuri, për sa i përket:

- a) Burimit - Në deklaratën e vitit 2003 deklarohet se është krijuar nga të ardhura nga paga e subjektit dhe nga të vëllait, z. M. D., në emigracion, nga viti 1993. Ndërsa në Deklaratën - Vetting deklarohet si burim i krijimit kursimet nga të ardhurat
- b) Pjesëve takuese- Në deklaratën e vitit 2003 deklarohen se janë 50%, ndërsa në Deklaratën - Vetting deklarohet se ka 100% pjesë takuese.

2.1.2 Në lidhje me këtë mospërputhje, subjektit iu kërkuan sqarime të mëtejshme. Nga ana e subjektit nuk është dhënë asnjë argumentim, se cili ka qenë shkaku që ka deklaruar si burim të ardhurash pagën e vëllait emigrant në vitin 2003 për blerjen e këtij apartamenti, si dhe nuk dorëzohet asnjë dokumentacion provues për të provuar deklaratimet e tij.

2.1.3 Duke qenë se subjekti nuk ka dorëzuar asnjë dokument justifikues për të vërtetuar kryerjen e pagesave referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se çmimi i shitjes është caktuar 19.600 USD, vlerë e cila do të shlyhej me këste si më poshtë:

- a. 30% paradhënie në vlerën 588.000 lekë, në momentin e lidhje së kontratës;
- b. 30% nëse arrijnë punimet në katin IV;
- c. 30% me fillimin e punimeve të rifiniturës;
- d. 10% vlera e mbetur kur të dorëzohet objekti i përfunduar.

2.1.4 Në nenin 4, paragrafi 2, të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.08.2007, parashikohet se: *Shuma e mësipërme është likuiduar plotësisht nga ana e blerësit në favor të sipërmarrësit ndërtues në afatet e përcaktuara në kontratën e porosisë individuale*.

2.1.5 Bazuar në shkresën nr. ***, datë 29.12.2017, të OSHEE-së rezulton se subjekti ka pasur kontratë me OSHEE-në për këtë apartament, duke filluar nga viti 2000.

2.1.6 Me shkresën nr. *** prot., datë 8.01.2018, të ZVRPP-së Tiranë, rezulton se pallati, në të cilin ndodhet apartamenti në pronësi të subjektit Bashkim Dedja, është regjistruar në ZVRPP në vitin 1997, në bazë të vendimit të **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** nr. ***, datë 14.11.1997, e cila ka vendosur:

*“Pranimin e kërkesës të Gjykatës së Apelit për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të një pallati banimi ndërtuar në rrugën “***”, nga kërkuesi si investitor nëpërmjet shoqërisë “***” sh.p.k si sipërmarrës...”*

Për sa më sipër, rezulton se apartamenti i banimit ka qenë i përfunduar që në vitin 1997.

2.1.7 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë të vitit 2011, rezulton se vlera e kësaj pasurie, në bazë të procesit të rivlerësimit është 16.080.056 lekë, vlerë e cila nuk është pasqyruar në Deklaratën - Vetting. Bazuar në pikën 1, germa “e”, të urdhrit nr. 475, datë 11.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”, ku parashikohet se:

“Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk kanë pasqyruar saktë vlerën e asetëve, të të ardhurave apo detyrimeve dhe ose sipas monedhës përkatëse”.

2.1.8 Nga analiza ekonomike rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur aftësi paguese për të paguar këstin e parë të apartamentit në vitin 1997, i cili nuk justifikohet me të ardhurat e vërtetuara. Për periudhën deri në vitin 31.12.1996 (subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga në vlerë 510.223 lekë). Referuar aneksit të kontratës së porosisë, datë 05.02.1997, datë në të cilën është prenotuar apartamenti me sip . 98 m², në momentin e nënshkrimit të kontratës është kryer pagesa prej 588.000 lekësh për firmën “***”.

Vitet	Paga neto
1994	46.807
1995	205.866
1996	257.550
Totali	510.223

2.1.9 Nuk ka mandate pagese, transfertë apo ndonjë dokument tjetër për të justifikuar këtë pagesë. Nga ana e subjektit nuk justifikohet vlera e këstit të paguar, me të ardhurat e deklaruara. Pa llogaritur shpenzimet për jetesë në këtë periudhë, subjekti ka diferencë të ardhurat me shpenzime në vlerë -77.777 lekë.

Gjithashtu, nuk jepen të dhëna për likuidimet e këstit të dytë dhe të tretë (referuar kontratës së porosisë të datës 05.02.1997).

Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar: burimin e të ardhurave dhe pjesëve takuese, për të vërtetuar shlyerjen e kësteve të këtij apartamenti, si dhe për të provuar me të ardhura blerjen e këtij apartamenti. Shpjegimet e subjektit për këtë barrë prove ishin si më poshtë:

2.1.10 Ky apartament është përfituar nga pallati i ndërtuar për Gjykatën e Apelit Tiranë, ku ai punonte, nga firma “***” sh.p.k., bazuar në një Vendim të Këshillit të Ministrave, të viti 1996, me çmimet e Entit të Banesave të asaj kohe.

2.1.11 Ky pallat ka filluar në vitin 1997 dhe ka përfunduar në vitin 1999, ndërsa disa punime janë kryer më vonë. Ai ka prenotuar apartamentin në vitin 1997 dhe është futur në banesë në vitin 1999, kontrata e shitjes është realizuar në vitin 2007. Kur ka prenotuar këtë apartament, ka rënë dakord me vëllain M., që ta merrnin bashkërisht dhe të kontribuonin bashkërisht për ta blerë atë, pa dokument të shkruar, pavarësisht se kontrata ishte vetëm në emrin e tij. M., ishte në trungun familjar, dhe gjithçka ishte e përbashkët, nuk kishin asgjë të ndarë, ai ishte emigrant në Greqi. Ai ka kontribuar për shlyerjen e fillimit të pagesës së apartamentit, por më vonë, pasi ai bëri dokumentet e emigrantit të ligjshëm në Greqi dhe u stabilizua atje dhe krijoi familjen e tij më vete, nuk pati më interes për të vazhduar të ishte pjesë e këtij apartamenti.

2.1.12 Prandaj, edhe kur është bërë deklarimi fillestar i pasurisë në vitin 2003, M., është deklaruar edhe si kontribuues në pjesën 50 % të këtij apartamenti, duke iu referuar marrëveshjes verbale si vëllezër, të bërë në fillim. Kur është bërë kontrata e shitjes, në vitin 2007, Mensuri nuk ishte pjesë e kontratës për shkak se ishte stabilizuar në Greqi dhe kishte krijuar familjen e tij më vete. Prandaj, edhe në deklaratën e vitit 2007, kur është bërë kontrata e blerjes së apartamentit dhe në Deklaratën - Vetting, M., nuk është pjesë e apartamentit.

2.1.13 Pagesa e kësteve të apartamentit është bërë ndaj firmës “***” sh.p.k., në kohë të ndryshme, se përndryshe nuk lidhej kontrata e shitjes, vërtetimet e pagesës nuk i disponon. Ndërsa nga firma “***” sh.p.k. konfirmohet, më shkresën datë 16.04.2018, se janë kryer pagesat për këtë apartament nga ai. Në lidhje me mospërputhjet e vlerave të detyrimit ndaj firmës “***” sh.p.k., të deklaruara në vitin 2003 në shumën 200.000 lekë, ndërsa në vitin 2005 ky detyrim rezulton në shumën 2.600 USD, ndërtimi i pallatit do të bëhej me çmimet e Entit të Banesave dhe standardin që përdorte Enti i Banesave. Disa punime janë kryer edhe pas përfundimit të pallatit. Në ndërtimin e pallatit, firma ndërtuese përdori disa materiale të ndryshme nga ato të parashikuara në fillim, të cilat ishin më cilësore dhe më të shtrenjta, si çmim, si dritaret e duraluminit, dyert e jashtme etj., për rrjedhojë bëri që të ndryshojë dhe vlera e detyrimit, prandaj ka ardhur dhe mospërputhja e të dhënave në këtë rast.

2.1.14 Në lidhje me rivlerësimin e këtij apartamenti në vitin 2011, në vlerën 16.080.056 lekë, nga vlera fillestare që kishte në vitin 2007, dhe mospasqyrimin e këtij rivlerësimi në Deklaratën - Vetting, ka ndodhur pasi rivlerësimi i tij është bërë thjesht duke u bazuar në çmimin minimal fiskal shtetëror të përcaktuar me ligj, sipas zonave ku ndodhej prona.

2.1.15 Rezulton se këtë vlerë rivlerësimi, kjo banesë e ka marrë automatikisht, për shkak të parashikimit të ligjit dhe nuk ka qenë kontribut i tij që ia ka shtuar këtë vlerë nga çmimi i blerjes. Shteti, në një moment tjetër mund të ndryshojë përsëri vlerën që është aktualisht për metër katror, duke e rritur apo ulur atë, sipas hartës së zonave të banimit, në përputhje me politikat e tregut që shteti ndjek, duke sjellë përsëri ndryshim të rivlerësimit të kësaj pasurie. Prandaj, ky rivlerësim banese nuk është përfshirë në Deklaratën - Vetting, pasi nuk është vlerë e shtuar tej vlerës së blerjes apo çmimit dysheme që ka vendosur shteti në atë kohë.

2.1.16 Do të ndryshonte situata, në qoftë se me ekspert do të ishte kryer një rivlerësim tjetër i këtij apartamenti, tej çmimeve standarde minimale për metër katror të vendosura nga shteti, ku të përfshihej dhe vlera e shtuar për shkak të tregut apo shtesave që mund të kisha bërë në banesë. Në rastin konkret, rivlerësimi u është referuar çmimeve dysheme të përcaktuara nga ligji, si dhe në indeksin e çmimeve minimale sipas ZVRPP-së.

2.1.17 Subjekti i rivlerësimit deklaroi ka pasur edhe angazhime të tjera, krahas punës si gjyqtar, konkretisht i angazhuar me mësimdhënie, komisione, borde të ndryshme etj., dhe ka krijuar të ardhura ku, për një pjesë të tyre, nuk ekzistojnë dokumente, pasi ato nuk mbahen prej meje, por nga institucionet përkatëse.

2.1.18 Në lidhje me konstatimin tuaj se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur aftësi paguese për këstin e parë të pagesës në vitin 1997, për apartamentin në Njësinë Nr. ***, Rr. “***”, pall. ***, sqaroj:

2.1.19 Nga viti 1993 deri në vitin 1997, shuma totale e të ardhurave personale rezulton të këtë qenë në vlerën 650.000 lekë, shumë që tejkalon këstin e pagesës prej 588.000 lekësh, që është përcaktuar në kontratë për vitin 1997. Por, duke përfshirë dhe kontributin që ka dhënë edhe vëllai im, M., siç e kam deklaruar më parë, -pasi vëllai punonte në emigracion që nga viti 1993 dhe në atë kohë ishte pjesë e trungut familjar, -justifikojnë plotësisht burimin e të ardhurave të blerjes së këtij apartamenti.

2.1.20 Nuk ekzistojnë të derdhura kontributet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, rrjedhimisht dhe paga për periudhat tetor - dhjetor 1993, maj - dhjetor 1994, ku ka qenë gjyqtar. Po ashtu, nuk figuron as periudha gusht - tetor 1993, ku ka punuar si jurist pranë Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë. Gjithashtu, pas përfundimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Peshkopi, ka punuar në Ndërmarrjen Gjeologjike Mat, në Batërr të Martaneshit, në v. 1988-1999.

2.1.21 Për këtë banesë, në fillim ka kontribuar dhe vëllai, M., i cili punonte në emigracion, pasi ishim pjesë e një trungu familjar dhe, për pasojë, ekonomia në atë kohë ishte e pandarë. Prandaj ka pasur burime të ardhurash për të paguar këstin e parë të banesës në fjalë në Rr. “***” (“***”) e më pas edhe blerjen e kësaj banese.

Analizimi i provave

2.1.20 Vërtetimi datë 16.04.2018, i shoqërisë “***” sh.p.k., është i pavulosur me vulën e firmës dhe, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë. Në këtë vërtetim deklarohet se z. Bashkim Dedja

ka shlyer sipërmarrësin “***” sh.p.k. në vlerën e plotë, por nuk deklarohet data e shlyerjes së kësteve dhe as nuk bashkëlidhet asnjë mandat pagese apo dokumentacion provues nga ana e kësaj shoqërie për të vërtetuar datën e kryerjes së këtyre pagesave.

2.1.20.1 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë apartament ndryshon deklaram dhe deklaron si burim dhe të ardhurat nga vëllai i tij, z. M. D.

2.1.20.2 Ky deklaram nuk është në përputhje me deklaramet e tij në Deklaratën - Vetting, por edhe në pyetësorë, ku ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat dhe kursimet, duke deklaruar në përgjigje të pyetësorit se: “**sigurisht, burimi kanë qenë të ardhurat e mia**”.

2.1.21 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë pallat deklaron se ai ka filluar të ndërtohet në vitin 1997 dhe ka përfunduar në vitin 1999. Ky deklaram nuk është në përputhje me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, nga ku rezulton se me shkresë nr. *** prot., datë 08.01.2018, ZVRPP Tiranë na informon se pallati, në të cilin ndodhet apartamenti në pronësi të subjektit Bashkim Dedja, është regjistruar në ZVRPP në vitin 1997, në bazë të vendimit të **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** nr. 5820., datë 14.11.1997. Me anë të këtij vendimi, Gjykata ka **vendosur**: “*Pranimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të një pallati banimi, ndërtuar në rrugën “***”, nga kërkuesi si investitor, nëpërmjet shoqërisë “***” sh.p.k si sipërmarrës.*”

2.1.22 Në lidhje me mospërputhjen e detyrimeve ndaj “***” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit deklaron se ato janë të ndryshme, pasi nga ana e shoqërisë janë përdorur materiale më cilësore dhe më të shtrenjta, si çmim, të cilat kanë sjellë si pasojë edhe ndryshimin e detyrimit.

2.1.22.1 Subjekti i rivlerësimit, me anë të këtij deklarami, na informon se çmimi i apartamentit nuk është ai i deklaruar, për sa kohë edhe detyrimet ndaj “***” sh.p.k., nuk janë ato të deklaruara prej tij.

2.1.22.2 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk është koherent me deklaramet e tij, pasi pallati ka përfunduar në vitin 1999 dhe, për sa kohë deklaramet janë të vitit 2003 dhe 2005, ato nuk kishin si të ishin të ndryshme.

2.1.23 Në lidhje me mosdeklarimin e vlerës së rivlerësimit për këtë apartament, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të sakta, pasi ky rivlerësim është kryer nga ana e tij, me kërkesë të tij, dhe për këtë rivlerësim ai ka paguar dhe shumën 141.755,80 lekë.

Me kryerjen e rivlerësimit ai ka ndryshuar çmimin e apartamentit të tij, fakt që duhet ta deklaronte, sipas parashikimeve ligjore.

2.1.24 Në lidhje me mungesën e të ardhurave për aftësinë paguese nga ana e subjektit, është përdorur sërish fakti se një pjesë e të ardhurave e ka dhënë z. M. D., burim i cili nuk është pasqyruar në Deklaratën e Pasurisë – Vetting, por vetëm pas konstatimit të Komisionit të paaftësisë financiare të tij, ai ka përdorur si burim të ardhurat e vëllait të tij, por pa depozituar asnjë dokument provues për këtë kontribut.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën - Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe avokati i tij gjatë seancës dëgjimore, arrij në përfundimin se:

- i) Subjekti në lidhje me këtë apartament ndryshon deklarin fillestar të kryer në Deklaratën - Vetting, dhe përdor si burim për këtë pasuri të ardhurat nga vëllai i tij, z. M. D. Ky deklarin nuk është në përputhje me deklarin e tij në Deklaratën - Vetting, por dhe gjatë pyetësorëve, ku ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie *kanë qenë të ardhurat e mia*.
- ii) Për sa më sipër, rezulton se nga ana e subjektit jemi në kushtet e deklarimit të rremë në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruar për blerjen e këtij apartamenti.
- iii) Ka mosdeklarim të vlerës së apartamentit të rivlerësuar në kundërshtim me pikën 1 germa “e” të urdhrin nr. 475, datë 11.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
- iv) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie për të ardhurat e vëllait të tij në Greqi, z. M. D. Këto deklarime të tij nuk mbështeten në dokumentacion ligjor provues.

3. Në lidhje me apartamentin në përdorim në Golem, në pronësi të vëllait të tij, z. L. D., blerë me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.09.2003, me vlerë 1.900.000 lekë.

3.1.1 Bazuar në shkresën nr. ***, datë 29.12.2017, të OSHEE-së, rezulton se subjekti ka kontratë furnizimi energjie elektrike me OSHEE-në, për një apartamentin në Golem, adresa e të cilit lidhet me apartamentin në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. L. D.

3.1.2 Subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, deklaron se ka përdorur një apartament dhomë e kuzhinë në pronësi të vëllait L. D., të ndodhur te *** në Golem, Kavajë.

4.1.3 Në lidhje me këtë fakt subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime. Ai pranoi lidhjen e kontratës me OSHEE-në, që nga momenti i hapjes së saj, për këtë apartament, duke argumentuar, se që të dy vëllezërit nuk jetojnë afër dhe kjo ka qenë arsyeja që kontrata e OSHEE-së është në emër të tij.

4.1.4 Nga ana e subjektit vazhdojnë të paguhen faturat e energjisë elektrike për këtë apartament. Atij iu bënë pyetje shtesë, nga të cilat konfirmohet fakti, që faturat e energjisë elektrike për apartamentin në pronësi të vëllait të tij, z. L. D., vazhdojnë të paguhen nga ana e tij.

4.1.5 Nisur nga deklarin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 60 m², në Kryemëdhenj, Golem, si dhe të dhënat e dërguara nga ISSH-ja (Drejtoria Rajonale

Dibër), nr. *** dhe *** prot., datë 16.02.2018, vërtetohet se z. L. D., ka realizuar, për periudhën 1994 - 2003, shumën prej 1.337.929 lekë, të ardhura mbi bazë të të cilave është derdhur kontribut (me punëdhënës Ndërmarrjen Pyjore Peshkopi).

4.1.5 Z. L. D., ka blerë gjithashtu një sipërfaqe toke 2000 m², në Durrës, në vitin 2003, në bashkëpronësi me vëllain tjetër M. D., me vlerë 900.000 lekë.

Sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar se vëllai i tij, z. L. D., justifikon me të ardhura blerjen e këtij apartamenti, mbështetur dhe në faktin që kontrata e OSHEE-së rezultoi e lidhur në emër të z. Bashkim Dedja, të krijohen dyshime se ky apartament mund të jetë në pronësi të fshehur të subjekti të rivlerësimit. Shpjegimet e subjektit për këtë barrë prove:

4.1.6 Referuar nenit 3, pika 13 dhe 14, si dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tyre vetëm në qoftë se janë me cilësinë e dhuruesit, huadhënësit, huamarrësit me subjektin e rivlerësimit. Në rastin konkret, vëllai L. D., nuk ka asnjë nga këto cilësi, prandaj nuk ka detyrimin të justifikojë pasurinë e tij për arsye se nuk është subjekti i këtij ligji.

4.1.7 Megjithatë, vëllai L. D., ka paraqitur gjithë dokumentacionin që vërteton burimet e të ardhurave të tij ndër vite. Janë marrë parasysh vetëm të ardhurat nga paga për vitet 1994 - 2003, ndërsa nuk është marrë parasysh periudha e mëparshme në marrëdhënie pune me shtetin, që nga viti 1980 e në vazhdim, pa ndërprerje, sipas librezës së punës të hapur më datë 25.09.1980, apo vërtetimeve të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dibër.

4.1.10 Po ashtu, pas vitit 1990, ai ka pasur të ardhura edhe nga toka bujqësore, pemëtaria, blegtoria, bletaria, ku figuron i regjistruar dhe në regjistrin e fermerëve, regjistër i cili ka filluar të aplikohet shumë vonë në zonën ku ai jeton. Kjo provon faktin se vëllai ka ushtruar aktivitet fitimprurës. Këtë apartament (dhomë e kuzhinë), z. L. D., e ka marrë bashkërisht me vëllain tjetër, z. M., D. Pavarësisht se në dokumente është shkruar vetëm emri i njërit prej vëllezërve, L., sipas shpjegimeve të tyre, ata kanë kontribuar bashkërisht në blerjen e këtij apartamenti. Prandaj, duke analizuar dhe një herë gjithë dokumentacionin që ai ka dorëzuar, provohet se ai ka pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti. Në lidhje me këtë, subjekti depozitoi e kërkoi marrjen si provë të aktekspertimit, të datës 11.05.2018, të ekspertës kontabël B. S.

4.1.11 Lidhur me pyetjen pse kontrata e furnizimit me energji elektrike e apartamentit figuron në emrin e tij, subjekti shpjegoi se: kur e ka blerë këtë apartament i vëllai, L., kontrata e energjisë është bërë në emrin e tij, me kërkesën e tij, vetëm për lehtësi të pagesës së faturave, pasi në atë kohë subjekti punonte në Durrës, L. banonte në Dibër, ndërsa vëllai tjetër M. jetonte në Greqi. Kjo gjendje vazhdon edhe sot.

4.1.12 Pagesat e energjisë në përgjithësi kanë qenë tarifa e mirëmbajtjes së rrjetit, një faturë minimale, që varion nga 200 deri në 500 lekë në muaj. Bëjnë përjashtim vetëm dy muajt e verës ku shpenzimi ka qenë më i lartë.

4.1.13 Subjekti sqaron edhe një herë se kjo banesë nuk është në pronësinë e tij, as të ligjshme dhe as të fshehur, pasi ai nuk ka asnjë tager pronësie mbi të. Pasesa e faturës së energjisë elektrike për llogari të vëllait, në një vlerë simbolike, nuk mund të hamendësohet se është pronar i asaj pasurie. Nëse ajo pasuri tjetërsohet, nuk ka asnjë të drejtë të veprojë mbi këtë pasuri. Të drejtat e kësaj pasurie i gëzon vëllai, L.

4.1.14 Këtë apartament subjekti i rivlerësimit e ka përdorur disa herë gjatë verës, për shkak të marrëdhënieve që ka me vëllain, z. L. D. Subjekti nuk e ka fshehur faktin e përdorimit të këtij apartamenti dhe as të pagesës së faturës së energjisë elektrike. Në qoftë se do të kishte pasuri të fshehur, nuk do ta kishte deklaruar. Subjekti shumë lehtë mund të kishte bërë ndryshimet përkatëse në lidhje me emrin të faturat e energjisë elektrike, gjë të cilën nuk e ka bërë.

Analiza e provave

4.1.14 Argumenti i përdorur prej tij, se lidhjen e kontratës me OSHEE-në, që nga momenti i hapjes së saj për këtë apartament, e ka bërë në emër të tij, se të dy vëllezërit nuk jetonin afër, nuk qëndron, pasi kontrata mund të hapej në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe pagesat mund të kryheshin edhe nga ana e subjektit të rivlerësimit, për arsye të largësisë të paraqitur prej tij.

4.1.15 Vlera e pagesave të energjisë, tarifat e mirëmbajtjes së rrjetit, minimale, që variojnë nga 200 deri në 500 lekë në muaj, nuk shpjegojnë shkakun e lidhjes së energjisë për këtë banesë në emër të subjektit të rivlerësimit.

4.1.16 Në lidhje me aktekspertimin e datës 11.05.2018, të ekspertës kontabël B. S., që në objekt përcakton të ardhurat e siguruara nga punësimi i Latif Dedjes dhe familjes së tij për periudhën 1980 - 2003, konstatoj se:

- * Për kryerjen e këtij akti ekspertimi nuk është përmendur asnjë standard auditimi, referues, për mënyrën dhe zhvillimin e ekspertimit.
- * Eksperti kontabël, sipas përshkrimit të tij, është referuar në:... *dokumentacionin e paraqitur nga personi i interesuar, nga të dhëna të përgjithshme statistikore dhe informacione të marra nga ekspertë të fushës lidhur me të ardhurat në bujqësi dhe blegtori.*
- * Dokumentacioni i referuar nuk është i plotë dhe i saktë për të dhënë mundësi, për të arritur në konkluzione të sakta, si dhe ka gabime të ndryshme materiale, që ndikojnë në këto përfundime.
- * Nuk janë analizuar shpenzimet e familjes për periudhën referuese. Paraqiten të ardhurat e z. L. D., bashkëshortes dhe burimi i tyre, konkretisht: të ardhura nga punësimi për periudhën 1980 - 2003, fakte këto që do të ndikonin në vlerën e kursimeve të kësaj familjeje.
- * Në aktin e ekspertimit (në mënyrë kontradiktore) nuk shpjegohet si përcaktohet se për periudhën 01.01.1997 - 15.06.2004, znj. D. D., rezulton me pagesë kontributesh vullnetare të sigurimeve (sipas librezës së sigurimeve shoqërore). Ndërsa për të njëjtën periudhë i është llogaritur një pagë, që për periudhën 1998-2003, është vendosur 939.214 lekë.

- * Referuar të dhënave të disponuara, z. L. D., po dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë qenë të regjistruar për aktivitet privat, tregtar apo prodhues. Nuk rezultojnë kontrata për shitjen e produkteve të tyre bujqësore dhe blegtorale, për të cilat këta individë kanë realizuar të ardhura, si dhe kanë shlyer detyrimet përkatëse fiskale.

Sa më lart, akti i ekspertimit i paraqitur dhe konkluzionet e nxjerra prej tij, i bazuar në të dhëna jo të sakta dhe ligjore nuk mund të hedhë poshtë përfundimisht se:

Z. L. D., i vëllai, rezulton me pamjaftueshmëri të ardhurash për të justifikuar blerjen e apartamentit në Golem, në vitin 2003, në vlerë 1.900.000 lekë, si dhe blerjen si bashkëortakë të pasurisë tokë arë, ndodhur në Durrës, me sipërfaqe 2000 m², blerë me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.03.2002, me çmim 900.000 lekë.

4.1.17 Subjekti i rivlerësimit deklaron se faktin e pagesës së energjisë elektrike për apartamentin në pronësi të vëllait të tij e ka deklaruar vetë. Ky konstatim i tij nuk qëndron, pasi vetëm pas hetimit administrativ të Komisionit dhe dërgimit të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka qenë i detyruar të deklarojë faktin se kontrata e OSHEE-së është në emër të tij. Ky apartament, i cili përdoret nga ana e subjektit të rivlerësimit, duhet të ishte deklaruar që në plotësimin e Deklaratës-Vetting, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2, “Formulari i deklarimit të pasurisë”, të këtij ligji. Në lidhje me këtë apartament, rezulton se kontrata e energjisë elektrike është në emër të z. Bashkim Dedja dhe është hapur që në vitin 2003. Kontrata e energjisë fillestare hapet gjithmonë nga personi i cili është pronar i pasurisë përkatëse dhe nga askush tjetër, në këtë rast z. Bashkim Dedja.

4.1.18 Lidhur me deklarimin në deklaratën noteriale të z. L. D., se nuk është person i lidhur, për sa kohë nuk ka marrëdhënie në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, gjykoj se ky deklaram nuk është i saktë, pasi:

4.1.19 Për sa kohë kontrata e energjisë elektrike është në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe faturat e energjisë paguhen nga ana e tij, pa asnjë arsye të qenësishme, si dhe duke marrë parasysh faktin e deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit se ky apartament përdoret nga ana e tij, gjykoj se jemi në kushtet kur vëllai i tij, z. L. D., është personi tjetër i lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në sa më poshtë vijon:

4.1.20 Për sa pretendohet nga vëllai i subjekti të rivlerësimit, ai nuk rezulton “person i lidhur” me të, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, lidhur me konsiderimin e personit tjetër të lidhur. Është e vërtetë se dhurimi dhe huaja janë parashikuar posaçërisht dhe në mënyrë specifike nga ligji (neni 32, pika 4), të cilat për shkak të veçantisë së tyre (me të drejta vetëm për njërën palë dhe detyrime vetëm për palën tjetër) janë identifikuar nga ligjvënësi si premisa që lidhin subjektin e rivlerësimit me personat e tjerë të shfaqur si subjekte në këto marrëdhënie juridike-civile.

4.1.21 Nga ana tjetër, ligjvënësi nuk e ka kufizuar hetimin vetëm në këto marrëdhënie (dhurim, hua) dhe nuk përjashton marrëdhënie të tjera juridiko-civile midis subjektit dhe një personi tjetër, që rrjedhin nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Jo më kot kjo situatë është sqaruar që në fillim të ligjit, në nenin 3, pika 14.

4.1.22 Përkundër sa është pretenduar nga subjekti, se ai nuk ka një marrëdhënie me vëllain e tij, në rastin tonë marrëdhënia mes dy palëve, **është një marrëdhënie interesi e dukshme, e cila diktohet nga një interes pasuror, siç është përdorimi i apartamentit dhe pagimi i kontratës së energjisë elektrike.**

4.1.23 Në këtë deklaratë noteriale, gjithashtu nuk u arrit të sqarohet nga ana e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. L. D., se cila ka qenë arsyeja që kontrata e energjisë është hapur dhe është ende në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është paguar e vazhdon të paguhet nga ana e tij.

Arsyetimi ligjor

Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën -Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së dhe deklaratat periodike (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe avokati i tij gjatë seancës dëgjimore arrij në përfundimin se:

- i) Ka fshehje të përdorimit të këtij apartamenti, ndodhur te *** në Golem, Kavajë, nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2 “Formulari i deklaratimit të pasurisë”, të këtij ligji, të cilat përcaktojnë se *“ Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur”.*
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokumentacion të mjaftueshëm ligjor për të provuar se vëllai i tij, z. L. D., justifikonte me të ardhura blerjen e këtij apartamenti.

Për këto arsye, nisur nga analizimi i të gjitha sa më sipër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja:

- I) Nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të huas së marrë nga kunati i tij, z. E. C., në vlerën 10.000 euro, për pasurinë apartament me sipërfaqe 146.14 m² dhe garazh me sipërfaqe 15.25 m², me vlerë 180.000 euro, të ndodhur në Tiranë, P. “***”.
- II) Nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues burimin e ligjshëm të huas së marrë nga vëllai i tij, z. M. D., në vlerën 15.000 euro, për pasurinë apartament me sipërfaqe 146.14 m² dhe garazh me sipërfaqe 15.25 m², me vlerë 180.000 euro, të ndodhur në Tiranë, P. “***”.
- III) Ka kryer deklaratim të rremë në Deklaratën -Vetting, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara, për apartament banimi me sipërfaqe 98 m², me vlerë 19.600 USD (ose 1.812.020 lekë), në Njësinë Administrative Nr. 5, Rr. “***”, pallati *** , sh. *** , pasi nuk ka deklaruar si burim të ardhurat nga vëllai i tij, z. M. D.

- IV) Ka mosdeklarim të vlerës së apartamentit të rivlerësuar në kundërshtim me pikën 1, germa “e”, të urdhrin nr. 475, datë 11.05.2017, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
- V) Ka mosdeklarim të përdorimit të apartamentit në pronësi të vëllait, z. L. D., në Deklaratën -Vetting, në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2 “Formulari i deklarimit të pasurisë” të këtij ligji.
- VI) Nuk ka depozituar dokumentacion të mjaftueshëm ligjor për të provuar se vëllai i tij, z. L. D., justifikonte me të ardhura blerjen e këtij apartamenti.

SI PËRFUNDIM,

Për arsyet e sipërcituara, në pajtim me parashikimet e nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh provat e shqyrtuara dhe deklaratimet e bëra në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, nuk ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë, dhe për rrjedhojë, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e tij nga detyra.

RELATORE

Xhensila PINE